



Ndërmarrja Publike Lokale **KASTRIOTI** Sh.A

Adresa: Rr. "Vashingtoni" pn - Obiliq
Tel: +383 46666607; +383 48777624
Email: nplkastrioti@gmail.com; web: www.nplkastrioti.com

		Ndërmarrja Publike Lokale "Kastrioti" Sh.A Lokalno Javno Proizvede "Kastrioti" D.D Local Public Enterprise "Kastrioti" J.S.C	
Obiliq			
Data:		Nr. i Prot:	
Datum:	14.09.26	Br. Prot:	J-2262/26
Date:		Prot. No:	

Në mbështetje të Nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 15.06.2008, nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 30.05.2012, nenit 177 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 24.05.2018, nenit 30.1.8, nenit 30.1.14 të Statutit Nr. I-538/26 të N.P.L "Kastrioti" Sh.A., e miratuar me datë 30.03.2026 nga Komisioni Komunal i Aksionarëve të Komunës së Obiliqit, nenit 25 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike të publikuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, lidhur me Vendimin Nr. I-2292/26 të datës 11.09.2026 të marr nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Kastrioti" Sh. A, N.P.L "Kastrioti" Sh. A me datë 14.09.2026, shpall:

KONKURS PUBLIK I JASHTËM

I. Titulli: Kryeshef Ekzekutiv

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: Dyzetë (40) orë në javë

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: Për një periudhë tre (3) vjeçare, me mundësi vazhdimi

Përgatitja profesionale: Përgatitje universitare

Përvoja e punës: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale

I raporton: Bordit të Drejtorëve

Koeficienti i pagës: Caktohet me vendim të Bordit të Drejtorëve.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Bën planifikimin, organizimin dhe kontrollin e afarizmit të ndërmarrjes;
- Koordinon punët e ndërmarrjes në bashkëpunim me përgjegjësitë e njësive organizative, me qëllim të implementimit sa më të drejtë të politikave zhvillimore të caktuara nga bordi i drejtorëve.
- Përcakton një strategji efektive për ndërmarrjen;



- Menaxhon ndërmarrjen, si dhe raporton para bordit të drejtorëve lidhur me menaxhimin;
- Bashkëpunon ngushtë me bordin e drejtorëve dhe bën sistemimin dhe organizimin e të punësuarve konform dispozitave pozitive dhe të politikave zhvillimore të ndërmarrjes;
- Përfaqëson ndërmarrjen;
- Të drejtën për lidhjen e marrëveshjeve (kontratave) të ndryshme me palë të ndryshme;
- Zbaton vendimet e bordit të drejtorëve;
- Implementon strategjitë e definuara nga bordi.
- Implementon planin e biznesit të miratuar nga Bordi.
- Vendos për angazhimin e stafit për ndërmarrje.
- Të sigurohet që janë të zhvilluara politika dhe procedura efikase të burimeve njerëzore (duke përfshirë rekrutimin, menaxhimin e performancës, trajnimet, planifikimet e suksesshme, raportet e punonjësve dhe kompensimet) për të përkrahur objektivat strategjike të Ndërmarrjes.
- T'i ofrojë kurdo që të jetë e nevojshme, dhe së paku një herë në tre muaj, Bordit të Drejtorëve, raporte për transaksionet kryesore të ndërmarrja nga Shoqëria dhe për vendimet kryesore të ndërmarrja nga menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e biznesit dhe të punëve të Shoqërisë;
- T'i ofrojë Komisionit të Auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkojnë;
- T'i ofrojë Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkojnë nga ky i fundit;
- Përpilon planin vjetor bazuar në principet e shpenzimeve. Planifikimi duhet të përmbajë të hyrat e pritura, shpenzimet. Planifikimin vjetor të investimeve dhe burimin e financimit;
- Kryen edhe punë tjera të nevojshme për funksionimin e ndërmarrjes.
- Për punën e tij i përgjigjet Bordit të Drejtorëve.

II. Titulli: Zyrtar Kryesor Financiar

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: Për një periudhë tre (3) vjeçare, me mundësi vazhdimi

Përgatitja profesionale: Fakulteti ekonomik

Përvoja e punës: Së paku tre (3) vite përvojë pune nga fusha e financave dhe/ose kontabilitet

I raporton: Bordit të Drejtorëve

Koeficienti i pagës: Caktohet me vendim të Bordit të Drejtorëve.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kujdeset për menaxhimin e llogarisë bankare të ndërmarrjes.
- Kryen transaksionet financiare të ndërmarrjes.
- Kontrollon pagesën e faturave.
- Bën kontrollin financiar të pasurisë dhe parave të gatshme.
- Do të menaxhojë, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE çështjet financiare të ndërmarrjes.
- Varësisht prej kufizimeve të vëna nga bordi i drejtorëve, do të ketë autoritetin e lidhjes të gjitha kontratave financiare për ndërmarrjen.
- Të monitorojë llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe të gjitha blerjet;
- Të rishikojë shpenzimet e faturave të arritura dhe të sigurojë mjete për realizimin e tyre;
- Të përgatisë të dhënat e ndërmarrjes për auditim;
- ZKF është përgjegjës për veprimtarinë e rregullt dhe të ligjshme financiare të organizatës përkatëse buxhetore, agjencisë autonome ekzekutive ose ndërmarrjes publike;
- Të bashkëpunojë me KE dhe zyrën e prokurimit të ndërmarrjes;
- Menaxhonthesarin e ndërmarrjes;
- Të vendosë dhe përgatitë buxhetin e ndërmarrjes, si dhe
- Çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar me akte normative të ndërmarrjes.
- Për punën e vet i raporton Bordit të drejtorëve të ndërmarrjes.

➤ **Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
 - Të ketë zotësi të plotë veprimi.
 - Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
-

- Kushtet e veçanta që duhet ti plotësojnë të gjithë kandidatët për pavarësi dhe përshtatshmëri profesionale të përcaktuara me nenin 17.1 dhe 17.2 pikat d, f, j, k dhe l të parapara me nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

➤ **KRITERI I KUALIFIKIMIT**

Sipas nenit 17, pika 17.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike një person nuk mund të kualifikohet si Kryeshef Ekzekutiv apo Zyrtar Kryesor Financiar nëse ka njërën nga mangësitë e cekura si në vijim:

- Një person që pretendon të bëhet Kryeshef Ekzekutiv apo Zyrtar Kryesor Financiar nuk duhet të jetë i dënuar ose vendosur nga një gjykatë kompetente, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë tjetër në bazë të ankesës, se ka kryer vepër penale ose civile vepër penale apo civile që përfshin përgënjeshttrimin, prezantimin e rrejshëm, korrupsionin, vjedhje, pastrimin e parave, përvetësimin, keqpërdorimin apo ndarjen e rrejshme të fondeve, ka qenë i përfshirë në mitosje apo ryshfet sipas ligjeve apo rregulloreve në fuqi në Kosovë apo ndonjë vend tjetër, apo sipas traktateve ose konventave ndërkombëtare;
- Nuk është vendosur nga një gjykatë ose organ apo organizatë përgjegjëse për zbatimin e kodit etik apo standardeve të sjelljes profesionale, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër në bazë të ankesës (i) se është angazhuar në sjellje jo-profesionale, (ii) se ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, (iii) se ka keqpërvetësuar apo ka keqpërdorur paratë apo burimet publike, (iv) se keqpërdorur apo keqpërvetësuar informatat (të dhënat) e fituara gjatë shërbimit si zyrtar publik apo shërbyes civil, ose (v) se ka keqpërdorur postin publik ose postin në shërbimin civil për përfitime personale ose për përfitime apo përparësi të një të afërmi ose të njohuri; apo;
- nuk ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim apo betimi tjetër, ose dokumenti të vulosur apo noterizuar;
- Nuk është shpallur i falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara

➤ **KRITERET E PAVARËSISË**

Sipas nenit 13, par. 1 të Ligjit Nr. 04/L-011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike një person nuk mund të kualifikohet si Kryeshef Ekzekutiv apo Zyrtar Kryesor Financiar, nëse ka njërën nga mangësitë e cekura si në vijim:

- (d) Është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj; Aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të lartë në NP-në përkatëse brenda tri (3) viteve të kaluara;
- (f) Mban drejtorësi të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së përkatëse përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe;
- (j) Është ose (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionari, ose ka një Interes Financiar në, një shoqëri tregtare të pa-listuar dhe që konkurron me Ndërmarrjen, ose (ii) menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy përqind (2%) të të drejtave të votimit) i, ose ka një Interes të konsiderueshëm Financiar në, cilëndo nga shoqëritë tregtare të listuara që konkurrojnë me Ndërmarrjen
- (k) Ai është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- (l) Ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktojnë që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.
- Nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse.

➤ **Aplikacionit duhet bashkangjitur:**

- Formulari për aplikim i N.P.L "Kastrioti" Sh. A (i cili merret në zyrën e arkivës të ndërmarrjes);
- Një deklaratë nën betim të nënshkruar nga kandidati se i plotëson kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.1 dhe 17.2 d, f, j, k dhe l. (Kjo deklaratë merret në Zyrën e Arkivës të Ndërmarrjes);
- Rezume për jetëshkrimin e kandidatit
- Letër Motivuese
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për kualifikimin Universitar (e skanuar)
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara)
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar)

- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale plotësuese që e pengojnë në ushtrimin e kësaj pozite në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen)

➤ **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.**

- Intervista me gojë deri në tetëdhjetë (80) pikë.
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në njëzetë (20) pikë.

➤ **Periudha e aplikimit të kandidatëve**

Konkursi mbetet i hapur njëzetë e një (21) ditë kalendarike nga dita e publikimit, dhe atë nga **14.09.2026** deri me datë **05.10.2026** në ora **16:00**.

Arsyeja pse data 05.10.2026, është data e fundit e aplikimit dhe jo data 04.10.2026 e cila do të ishte dita e njëzetë e një (21) qëndron në nenin 81 par. 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative e cila po citohet si në vijim: *"4. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk do të pengojnë fillimin dhe ecjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie të shtunën, të dielën apo një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen menjëherë pas saj."*

➤ **Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët**

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim dhe deklaratën nën betim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L "Kastrioti" Sh. A në qytetin e Obiliqit çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: bordi.nplkastrioti@gmail.com

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet dhe dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë shpallje si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.

➤ **Sqarim**

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

➤ **Përfundim**

N.P.L "Kastrioti" Sh.A. në Obiliq ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë gratë të cilët i plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e ndërmarrjes në gjithë Republikën e Kosovës.